



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. I-102
Br.

Data 23.07.2018
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI, mbledhja e 10) me dt.31.07.2018 (e martë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit veprues 2018-2021 për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas të Komunës së Obiliqit
4. Shqyrtimi i raportit gjashtë (6) mujor të punës së Kryetarit të Komunës
5. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017 (Zyra Kombëtare e Auditimit)
6. Shqyrtimi i kërkesës së DMM-së, për vënjen në mbrojtje të monumenteve të natyrës
7. Shqyrtimi i Memorandum Mirëkuptimi të Kryetarit të Komunës dhe katër komunave tjera , që pasuria natyrore e bjeshkëve të Qyqavicës e cila shtrihet në territorin e pesë (5) komunave të shpallet zonë me interes të përgjithshëm
8. Shqyrtimi i propozimit të DPUKP për shpallje me intres publik , hapësirat e sheshit dhe për rreth tij në zonën e parë të qytetit
9. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri





Dalës-Izlasna

Nr. I-91

Data 29.06.2018
Datum

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

OBILIĆ-OBILIĆ

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.29.06.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta anëtarë: Burim Gërguri, Labinot Mirena, Enver Gashi, Florije Jashari, Shaip Paloja, Fatos Kurshumlja, Fatmir Bekteshi, Linda Sadiku, Arbnore Nasufi, Hysni Mjeku, Lulzim Sadiku, Samire Berisha, Aziz Bici, Xhezide Dragusha, Armend Rushiti, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Përparim Klinaku, drejtor i adm. së përgjithshme, Naim Miftari, drejtor i DSHPE-së, Enver Grajqevci, drejtor për infrastrukturë lokale, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, Burim Ismaili, drejtor i DI-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DFEZH, Agim Spahiu, drejtor i DKA-së, Fitore Hashani, drejtoreshë e DMM-së, Daut Mjeku, udhëheqës për ekonomi dhe zhvillim, Kaltrina Spahiu, zyrtare e lartë për planifikim dhe zhvillim, Osman Kabashi, zyrtar i lartë për planifikim dhe zhvillim, përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores sipas rekomandimeve të MAPL-së
 - Rregullorja e Punës të Kuvendit të Komunës
 - Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale
4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore3 (KAB) për periudhën 2019-2021
5. Të ndryshme

Burim Gërguri – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Miratohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

1. Pika e parë e rendit të ditës –

Mungoi: Qëndresa Dubova (me arsye) dhe Agon Mjekiqi (ndodhet jashtë vendit)

2. Pika e dytë e rendit të ditës –

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Pika e tretë e rendit të ditës -

Burim Gërguri – Lexon shkresën nga MAPL-ja, për shqyrtimin e ligjshmërisë të Rregullores së punës së Kuvendit komunal. Vërejtjet nga MAP-ja, kryesisht kanë qenë te emërtimi këshilltarë komunal dhe tash sipas LVL-së, është anëtarë i Kuvendit komunal.

Drita Hashani – Bazuar në kompetencat e pushtetit lokal, ne kemi vepruar ashtu që në vend të termit këshilltar komunal e kemi vendosë termin anëtarë i Kuvendit komunal, kështu që ne e kemi harmonizue Rregulloren komplet e cila është shqyrtue nga MAPL-ja. Poashtu, kanë qenë edhe 2 vërejtje të vogla sa i përket renditjes, por edhe këtë e kemi rregullue.

Dragan Dancetovic – Unë në mbledhjen e kaluar të Kuvendit kam dhënë një vërejtje dhe po e shoh se ndërkohë Ministria e ka kthyer, por me gjasë kjo ka kaluar e pavërejtur. Unë edhe më tutje, konsideroj se neni 18 i Rregullores së vitit 2008 duhet bartur në Rregulloren e re. Rregullorja e re është më e zgjeruar dhe është e punuar në mënyrë profesionale, por dua t'jua rikujtoj edhe një herë se neni 18 përfshin ashtu siç thotë këtu edhe grupet e ndjeshme, e këtu supozohet në pakica, në gra dhe persona me nevoja të

veçanta. Për këtë arsye mendoj se Rregullorja e re do të jetë më e plotë nëse neni 18. vendoset në Rregulloren e re.

Burim Gërguri – Vërejtjet e z.Dancetovic, ligji i regullon dhe ne po flasim për një dokument i cili është çështje e brendshme e Kuvendit komunal. Është ligji i barazisë gjinore, që përcakton kuotën që ne detyrimisht jemi të obliguar me respektue. Poashtu është edhe Ligji për pakicat, të cilat jetojnë në çdo territor të Komunës dhe gjuha zyrtare e cila përdoret është e rregulluar si për komunitetin shumicë, ashtu edhe për atë pakicë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota “Për” dhe 1 votë “Kundër” morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal.

Burim Gërguri – Lexon shkresën nga MAPL-ja, për shqyrtimin e ligjshmërisë të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale. Këtu, kemi pasë rekomandime të Ministrisë së financave, që është në domenin e Komunës, por nuk është thënë se kjo Rregullore është e kundërligjshme.

Daut Mjeku - Vërejtjet e kësaj Rregulloreje më shumë janë procedurale dhe ne kemi shkue sipas ligjit dhe Komisionit që ka punue me këto përmirësime:

- Të shkruhet dhe të jenë standard, nr.12, e kemi përmirësue
- Tabela shkon në mes të rreshtave e kemi përmirësue
- Te neni 10, është përmirësue sipas Ministrisë së financave, se nuk ka Komision për shqyrtim të ankesave për taksa, tarifa dhe gjoha, por pas vendimit përfundimtar Komuna, ankesat vazhdojnë sipas Ligjit të procedurës së përgjithshme administrative
- Gjobat shqiptohen sipas Ligjit për kundërvajtje
- Dispozitat kalimtare, përfundimtare duhet të jenë në fund të tabelës
- Te Drejtoria e administratës së përgjithshme ti bëhen disa tabela psh aty ku thuhet se tarifat lëshohen për vërtetime, dokumente zyrtare, për ankesa të ndryshme dhe për ankesa që paraqiten kundër vendimit të cilin e bie organi i shkallës së parë të fshihen sepse për këto nuk mund të aplikohen taksa
- Në pikën 36, kompenzimi për medijtë të kurorëzimet bëhet sipas Ligjit të Shërbyesve Civil, e jo sipas kompenzimit të faljes, është përfshirë edhe të gjitha ato që janë në biznes
- Subjektet, bizneset në Komunën tonë të cilat janë njësi, nuk ka nevojë të futen në tabela, por të përcaktohen me 30 %, nga baza
- Tarifat komunale për transaksion të pronës, shumë e dhimbshme për neve vlera ka qenë dikund 30,000 €, thojnë se është taksë e dyfishtë dhe në bazë të ligjeve të tyre e kemi heqë këtë takes
- Te ngarkesa për shfrytëzimin e burimeve natyrore është e rregulluar me Ligjin për Obiliqin, thojnë ata ndërsa institucionet përkatëse kemi vendosë 20 %, të vlerës të kësaj rente të alokohet nga buxheti qëndror në buxhetin komunal
- Disa taksa nga DSHPE-ja, i kanë heqë që ndoshta është shumë e arsyeshme
- Gjobat për kyqje të ujësjellësit, të kanalizimit nuk janë kompetencë e Komunës, por e ka kompania
- Edhe një tarifë, që ne e kemi parë të arsyeshme me vjelë nga rrjeti kabllor dhe nëntokësor e ajror na kanë rekomandue që kjo të hiqet sepse është një lloj standardi
- Taksat ekologjike i kemi harmonizue me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor (MPH)

Lulzim Sadiku – Te taksat administrative për lëshimin e lejes, në m² është 1 euro e 91 cent, pse nuk e kemi paraparë në zona që mos të jetë leja e njejtë si në zonën e parë në Obiliq sikurse psh në Breznicë.

Daut Mjeku - Përgjegjet se kjo është kështu e përcaktuar dhe ajo taksë mund të ndërrohet çdo vit në muajin qershor në bazë të stafit të punëtorëve, inspektorit të ndërtimit dhe vlerës komunale pjesëtohet dhe delë çmimi.

Nazmi Gashi – Besoj se z.Daut Mjeku, është mundue me nxjerrë një dokument më të mirë tani për tani në këto kushte dhe në këto rrethana. Te neni 9, mendoj se është dashur të përfshihen në përgjithësi dëmet që shkaktohen edhe në pjesë të mjedisit ku është interesi i qytetarëve, ndërsa caktimi i afatit varet prej procedurës që e bëjnë inspektimin inspektorët dhe zyrtarët tjerë të administratës. Te neni 16, është

një pjesë e përcjellur nga territori i Komunës tonë i ndarë në 4 zona, dhe ne nuk i dijmë kufijtë e këtyre zonave, apo nuk i dijmë se cilat lokalitete hyjnë në këto zona. Ndoshta, është dashur me qenë një sqarim për këtë çështje, apo dikund po ruhet edhe në harta zonale, që për hartat ne sivjet për herë të parë kemi dëgjue. Megjithatë, kufijtë e zonave është dashur të dijmë sepse është punë pagese, është punë e pjesës që qytetarët jetojnë në ato hapësira. Ndoshta, më vonë drejtori i DPUKP, ka mundësi me na dhënë këtë përkrahje. Te inspektori i ndërtimit, për afërsisht tekstin që e kam bërë unë vetë para 15 vjete, prapë i njejtë qenka dhe pasi që po ndryshojnë ligjet, ligji i fundit ka përfshirë shumë gjëra të qarta dhe nëse, anëtarëve të Kuvendit ju intereson mund të marrin ligjet dhe me i bë barazimet. Mendoj se është zgjedhë ajo më e mira tani për tani që ka mund me u zgjedhë.

Burim Gërguri – Sqaron se ne e dijmë të gjithë se me Rregulloren për tatimin në pronë, e cila aprovohet çdo vit sipas Ligjit të buxhetit deri në zonën e 4, kjo çështje është e rregulluar. Ndërsa, sa i përket hartës zonale, që 2 vjet ka fillue me u implementue, është në procedurë në nivelin nacional.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota “Për” dhe 1 votë “Abstenim” morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.

IV. Pika e katërt e rendit të ditës –

Zarife Behluli – Sa i përket Qarkores buxhetore për vitin 2019-2021, janë të përcaktuara 3 grande: grandit i përgjithshëm 2 milion e 782,493 €, grandit i Arsimit 2 milion e 671,206 €, dhe grandit i shëndetësisë 646,470 €, që në total si grand qeveritar janë 6 milion e 100 mijë e 169 €. Pastaj, kemi huamarrjen në Arsim 9,145 €, huamarrja në shëndetësi 51,718 €, të hyrat vetanake janë 1 milion e 35,562 €, që në total buxheti komunal me grand qeveritar dhe me të hyra vetanake është 7 milion e 196,594 €. Tani, bëhet ndarja në kategoritë ekonomike paga dhe medijtje janë 4 milion e 33,000 €, mallra dhe shërbime 637,205 €, shpenzime komunale 300,000 €, subvencione dhe transfere 200,000 €, investime kapitale 2 milion e 26,389 €.

Tani, drejtoresha jepë sqarime detale për projektet kapitale në bazë të tabelave të paraqitura për të gjitha Drejtoritë komunale. Duke u bazuar në Ligjin për Obilinqin nr.05/L-044, Komuna jonë bënë planifikimin e projekteve në bazë të tantimës 20 %, që na e përcakton Ligji i Obilinqit. Ne e kemi edhe një numër staf shtesë që na e mundëson Ligji i Obilinqit: 3 inspektorë, 2 juristë, 3 ekonomistë, 3 inxhinjerë, 2 zyrtar të Prokurimit, 1 menaxher për Shtëpi të Kulturës, 1 staf për Qendrën e regjistrimit civil, 2 zyrtar për bibliotekën në Plemetin dhe 1 mirëmbajtës në Palestrën sportive “Adem Jashari” që në total stafi shtesë është 18.

Fatos Kurshumlija – Pyes te rregullimi i Palestrës sportive, shihet se janë 450,000 €, për cilën Palestër është fjala dhe ku do të ndërtohet.

Zarife Behluli – Përgjegjet se Palestra sportive është e rregulluar, por i ka disa mangësi që duhet me intervenue për me rregullue.

Shaip Paloja – Fillimisht nuk kemi informacion për mungesën e Kryetarit, mungesën e Nënkyetarit dhe nuk e di pse nuk janë sot prezentë në mbledhje. Ju z.kryesues e liruat nga mbledhja zyrtaren ligjore, që mendoj se është gabim sepse në çdo seancë ajo duhet të jetë prezentë lidhur me shumë Rregullore, që na kthehen nga MAPL-ja, ajo patjetër është e nevojshme dhe duhet të jetë prezentë.

Burim Gërguri – Sqaron se Kryetari është në një udhëtim, por sot edhe e ka ditëlindjen, ndërsa Nënkyetari është në pushim vjetor. Zyrtarja ligjore kishte takim për atë arsye edhe kërkoi leje.

Shaip Paloja – Korniza afatmesme në disa linja mendoj se është shumë e mangët kur të kemi parasysh se bëhet një Kornizë afatmesme buxhetore për periudhën 2019-2021 dhe shumë projekte e shumë linja vetëm përsëriten vit pas viti. Mendoj se kryesisht duhet ti kushtohet rëndësi të rinjëve, sa i përket shëndetësisë e shkollave tona, sidomos në kohën afatgjate të bëhet kontrolli i kohëpaskohshëm ose i rregullt i nxënësve në shkollat tona. Ne duhet të kemi parasysh se vijmë prej një Komune, që ndoshta jo në ballkan, por në evropë jemi Komuna më e ndotur dhe duke filluar prej parashkollorëve deri në

shkollën e mesme duhet të bëhet kontrolli i fëmijëve sepse gjithmonë preventiva është më e mirë se sa shërimi dhe më pak e kushtueshme. Këtu, nuk parashihet dhe po e ceku me qëllimin se bëhet fjalë për një kohë më të gjatë 2019-2021 dhe mendoj se duhet rregullisht të bëhet kontrolli i fëmijëve si dhe të ndahet linjë e veçantë për këtë çështje. Poashtu, gjatë fushatës janë përmendë shumë shiritat gjelbërues, por këtu për ambientin ka shumë pak, gjithëherë duke pasë parasysh se Komuna jonë është një zonë industriale dhe është mjaft e ndotur, nuk ka mjaft gjelbërim dhe ambient. Sa i përket Ligjit për Obiliqin, neve na erdhi një shkresë me disa projekte, që mendoj se këto projekte është dashur që paraprakisht të debatohen në Kuvend. Pastaj ne ti propozojmë projektet të cilat janë më të mira dhe më të domosdoshme në Komunën tonë, edhe pse unë nuk besoj se do të ketë financim prej Ligjit të Obiliqit sepse ne të gjithë e dijme se duhet të bëhen edhe disa amandamentime në Kuvendin e Kosovës. Mendoj se ky ligj edhe për një kohë të gjatë nuk do të gjen zbatim dhe të hyrat e Komunës, vit pas viti duhet të rriten. Mirëpo, këtu nuk e kam parë se janë të rritura sepse ne e dijme se kur fillon ndërtimi i Kosovës së re, do të operojnë shumë kompani të ndryshme të cilat duhet të kenë obligime ndaj Komunës tonë. Gjithashtu, ato mjete duhet të destinohen në vend të sigurtë dhe të domosdoshëm.

Burim Gërguri – Përgjegjet se kontrolli sistematik i fëmijëve ka fillue që 4 vjet, por drejtori i DSHMS-së, do të japë përgjegje për këtë çështje.

Shaip Paloja – Pyet se sa është duke u punue për mjekësinë sekondare që të ketë në Komunën e Obiliqit.

Ibush Mjekiqi – Përgjegjet se në raportin 6 muhor që keni me pasë në mbledhjen e ardhshme, do ta keni edhe raportin që është bërë në këtë vit dhe është viti i pestë që bëhet kontrolli sistematik i nxënësve, që nuk kërkon buxhet shtesë. Arsyeja është se kjo bëhet në orar të punës dhe ne nuk kemi mundësi me bë këtë sepse nuk ka vijë buxhetore për këtë punë. Te kujdesi shëndetësor dytësor, ne jemi mundue edhe në vitin e kaluar dhe këtë vit, që Instituti i mjekësisë të punës të futet në kompetencë të Komunës, por kjo është çështje e nivelit qëndror dhe ne jemi duke u munduar, mirëpo nuk varet krejtë prej neve.

Hysni Mjeku – Ne në mbledhjen e KPF-së, e kemi shqyrtue KAB-in, dhe i kemi dhënë disa vërejtje sepse nuk ishin specifikue disa gjëra, por meqë KAB-i, ndryshon në etapa dhe më tepër është si objektivë se deri ku kemi me mbërri, që është obligim ligjor me përkrahë dhe ne e kemi përkrahë. Shtojcën tjetër që na solli drejtoresha kishte me qenë mirë që Shtëpitë shëndetësore, të cilat nuk janë dhe që janë të ndërtuara e nuk punojnë të futen në këtë shtesë dhe qytetarëve t'ju jepen shërbime sa më cilësore shëndetësore sepse janë zona të thella rurale. Sa i përket projekteve në KAB, është dhënë vërejtje pse nuk është specifikue të dihet se ku psh janë dhënë 200,000 €, për eksproprijim, por ku, ose 200,000 €, janë dhënë në Breznicë, për çka janë dhënë. Meqenëse, drejtoresha e dha një arsytim dhe kjo Kornizë afatmesme buxhetore do të ndryshoj në etapa, nuk e kemi parë të arsyeshme me u ndalë, kështu që edhe KPF-ja, i ka sugjeru Kuvendit komunal që ta aprovon.

Aziz Bici – Fillimisht përshtypjen që e jepë kjo Kornizë, shihet se Korniza afatmesme, nuk është se dallon nga buxhetet paraprake për nga shpërndarja, përkatësisht vazhdon që pjesa më e madhe e buxhetit të shkoj në paga dhe medijtje. Investimet kapitale, që do të duhej të kishin përparësi nuk kanë rritje të madhe, ndërsa subvencionet po zënë vetëm një hapësirë simbolike të totalit të buxhetit. Duke marrë parasysh shqyrtimin e planit buxhetor që na keni dërguar, unë kam sjellë disa sugjerime konkrete që po përkojnë me kërkesat e qytetarëve, me përmbushjen e të drejtave themelore të tyre të cilat të tilla në këtë mënyrë duhet konsideruar si prioritet. Sa i përket sugjerimeve konkrete në bazë të kërkesave të banorëve të fshatit Grabofc, është shprehur nevoja jetike që të mundësohet lëvizja e cila po vështirësohet meqenëse banorët aktualisht nuk kanë transport publiko-privat, tash e sa vite. Rrugët ekzistuese ua pamundësojnë banorëve të Grabofcit lëvizjen me anë të transportit publiko-privat sepse njëra prej tyre është shumë e gjatë dhe e shprehur kur nuk ka frekventim të transportit përderisa rruga tjetër shfrytëzohet vetëm nga KEK-u. Kërkesa e fshatarëve të fshatit Grabofc, konsiston në mundësinë e shfrytëzimit të rrugës së KEK-ut, nëpër mihjen sipërfaqësore të Mirashit. Një kërkesë e tillë është shumë e arsyeshme dhe përbën të drejtën themelore të këtyre banorëve, prandaj konsideroj se është e rrugës të merret parasysh meqenëse, plotësimi i kësaj kërkesë përveç lëvizjes së fshatarëve, mundëson gjithashtu progresin ekonomik si dhe

një lidhje më të mirë të qyteteve përreth. Kërkesa e tillë nuk është se kërkon ndonjë shumë të madhe të mjeteve në krahasim me mundësinë jetike që ka mundësimi i shfrytëzimit të kësaj rruge nga banorët e Grabofcit. Kërkesa tjetër e banorëve të fshatit Baimoc, konsiston me nevojën e tyre për një fushë të vogël të sportit, që do t'ju mundësonte fëmijëve të tyre një hapësirë të sigurtë loje argëtimi dhe aktiviteti sportiv. Banorët rrëfejnë se ata ndjehen të diskriminuar dhe të neglizhuar nga Komuna, sepse një pjesë e atij fshati përkatësisht pjesa ku banojnë serbët ka një fushë sporti ndërsa, pjesa ku banojnë shqiptarët ju mungon një objekt i tillë, që do t'ju mundësonte fëmijëve të tyre aktivitete sportive. Poashtu, gjendja në oborrin e shkollës në fshatin Mazgit i Epërm, nuk i ngjan aspak një oborri të shkollës për shkak të gërmadhave të mbetura nga prishja e objekteve të vjetra. Prandaj e konsideroj me prioritet ndërtimin e rrethojës së shkollës, pastrimin e oborrit nga mbetjet e materialeve ndërtimore dhe ndërtimin e një kopshti afër fushës së sportit. Të futen në prioritet krijimi i kabineteve në përgjithësi nëpër të gjitha shkollat ku ato mungojnë. Unë e kam edhe një pyetje, nuk di se cila është arsyeja e mospërfundimit të projekteve të urës dhe rrugës Plemetin-Hamidi, kur tash e sa vite banorët e atyre anëve udhetojnë me kilometra të tëra për të ardhë në Obiliq. Megjithëse ura është në përfundim e sipër kërkesa jonë është të futet në planifikimin e buxhetit për vitin 2019, në mënyrë që kjo urë dhe rrugë të përfundoj dhe të funksionalizohet. Gjithashtu nuk e shohë se do të vazhdoj puna e ndërtimit dhe nuk është në projekt objekti i Shtëpisë së kulturës, që ka mbetë në gjysmë. Aty, nuk figuron se e keni caktue me prioritet, nëse është tregoni dhe krejtë është në rregullë.

Propozoj të blehen dhe të vendosen cenzorët për matjen e ndotjes së ambientit se ne jozyrtarisht jemi të informuar se ka, por asnjë raport nuk na është prezentue se çfarë vlera të ndotjes kemi në Komunën tonë. -Të ndahen mjete të mjaftueshme për studimin e fizibilitetit për projektin e kognjërimit sepse implementimi i një projekti të tillë përveç që ndikon pozitivisht në ekonominë familjare ndikon drejtëpërdrejtë edhe në ruajtjen e ambientit.

-Të bëhet rregullimi dhe mirëmbajtja e nënkalimeve të këmbësorëve në magjistralen Prishtinë-Vushtri.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, KAB-i ka ndryshime në buxhet, por do ti shqyrtojmë kur të aprovohet buxheti. Diçka që më duket jo shumë e drejtë është rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në Obiliq 20,000 €, të hyra, 10,000 €, grande. Asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve në Obiliq 508,000 €, plus grandit 79,000 €, rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit prapë 150,000 €, plus 50,000 bëjnë 200,000 €, dmth numri i madh i buxhetit po shkon komplet në Obiliq dhe po mbeten anash fshatrat që në Komunën tonë janë 19 fshatra. Ndërsa, vërejtje kam te mbjellja e drunjëve dekorativ 15,000 €, të hyra, 15,000 €, grande. Fatkeqësisht po ndjehem keq sepse në Komunën tone 70 %, e drunjëve të mbjellur janë të dëmtuar. Ne po ndajmë buxhet 30,000 €, pa e bërë një vlerësim pse po ndodhë kjo dhe inspektorët komunal nuk merren me këtë çështje. Vërtetë, ju të gjithë e kaloni rrugën Obiliq-Prishtinë dhe 70 %, është duke u dëmtue druri i cili është mbjellë 4 vitet e kaluara. Rruga Palaj-Obiliq, është 90 %, i dëmtuar druri i cili është mbjellë 4 vitet e kaluara. Te rregullimi i fushave sportive janë 70,000 €, që në fakt më duket se është një vlerë shumë e vogël. Ne për këtë Kornizë afatmesme do të kërkojmë që ndryshimet të bëhen në buxhet dhe do ta përkrahim. Unë kisha dashur përgjegje për të gjitha këto që i thashë më lartë.

Nazmi Gashi - Mangësinë më të madhe në veprimtarinë time e kam se buxhetin nuk mund ta marrë vesh, por është edhe radhitja jo e mirë që po nxjerrë telashe. Këtu, e pashë se paga dhe meditje janë 4 milion e 33,000 €, pastaj stafi pagat prapë thuhet 4 milion e 33,000 €, ku janë meditjet, që ndoshta, këto 33,000 €, janë meditje. Pra është shifër matematikore që të shtyn të mendosh pse. Mendoj se qe 3,4 vite nuk ka ndërrue asnjë shabllon as Zyra e Kryetarit, që është një shumë e madhe e mjeteve për material të shpenzimeve, por në fund të fundit ato dikush i kontrollon. Te DKRS-ja, ne e kemi pasë një takim me Institutin e GAP-it dhe fjalën e parë thotë hendeku në mes të institucioneve dhe qytetarëve në Komunën e Obiliqit, dmth e ka nisë me një fjalë shumë të rëndë se paska një hendek. Kjo do të thotë se informimi po çalon dikund, por sikur të kishim ndarë një buxhet për këtë Komuna e Graçanicës është afërsisht 10 vjet, pas neve dhe ajo i ka me radio lokale, me kanal televiziv, ndërsa Komuna jonë nuk e ka një gazetar

profesional, nuk e ka një radio lokale, nuk e ka një gazetar sportiv. Mendoj se këtu, drejtoreshë është dashur të ndahen mjete sepse pa mjete nuk vjen askush.

Fatmir Bekteshi – Unë kam një pyetje për drejtoreshën te stafi i Kuvendit komunal, nuk shkruan fare numri se sa ka staf Kuvendi ynë komunal.

Burim Gërguri – Ky është një projektion KAB-i, por do të vjen edhe raporti 6 mujor ku mund të jepen vërejtjet detale. Finalizimi i buxhetit bëhet në shtator dhe i kalon fazat e debatit publik. Unë uroj që më në fund Ligji për Obiliqin, që të funksionalizohet në vitin 2019 dhe kërkesa juaj për implikimet buxhetore të aprovohet njëkohësisht me KAB-in.

Zarife Behluli – Përgjegjet lidhur me shirirtat gjelbërues se ne e kemi një projekt që e kemi fitue nga Ministria e infrastrukturës, në vlerën prej 900,000 €, parku i Obiliqit që do ta shihni më vonë se si do të duket sheshi i Obiliqit. Të hyrat vetanake, po rriten vit pas viti, por është fat nëse funksionalizohet Ligji i Obiliqit dhe i bëjmë ato të hyra vetanake, e jo vetëm me qenë pjesë e grandit qeveritar. Sa i përket Shtëpive të shëndetit, ka nevojë me qenë një Shtëpi e shëndetit në lagjen Hadja e re, poashtu edhe shkolla, mirëpo për Shtëpitë që janë funksionale dhe nëse, janë në gjendje të keqe unë e di se DSHMS-ja, vit pas viti po bën investime në ato Qendra shëndetësore. Korniza buxhetore, normal që bëhet vit pas viti diçka ka me pasë të reja dhe çdo vit ka risi, por ne ende nuk kemi mund me dalë prej asfaltimit me i krye në të gjitha fshatrat, kështu që ne jemi të detyruar me i pasë vijat e projekteve të njejta. Në Qarkoren e dytë buxhetore mbetet të caktohen se cilat rrugë do të shtrohen dhe ne çdo vit në debatet publike i kemi harmonizue rrugët dhe krejtë buxhetin nëpër vija buxhetore, që është i caktuar. Pagat normal që e marrin buxhetin, jo vetëm në Komunën e Obiliqit por secilës Komunë në Ministri shumicën e buxhetit ia merrë. Mirëpo, pagat i kemi grand qeveritar me përjashtim te shëndetësia që i ka ndërrimet e natës dhe te shkolla e mesme teknike, që është mësimi joformal dhe ua caktojnë me të hyra vetanake. Transporti nuk është projekt kapital dhe shkon në mallra dhe shërbime. Shfrytëzimi i rrugës së KEK-ut, bëhet në bashkëpunim Komunë, KEK dhe Ministri dhe e di se Kryetari është marrë me këtë çështje, por nuk e di se deri ku ka mbërri. Sa i përket fushës së sportit në Baimoc, janë fushat sportive në projekt dhe nuk do të thotë se nuk do të bëhet edhe në Baimoc, ndoshta pikërisht edhe për këtë është planifikue. Ne i kemi projektet te Drejtoria e Arsimit për oborrit e shkollës dhe rrethojat e shkollave. Ura është donacion nga Ministria e infrastrukturës, Shtëpia e kulturës, është donacion nga Ministria e kulturës dhe sa e di unë janë në përfundim e sipër, kështu që ne nuk kemi nevojë të ndajmë mjete për projektet e fituara nga Ministrinë përkatëse. Tani, i përgjegjem z.Lulzim Sadiku për rrugën këtu, dihet se sado që e mirëmban ajo gjithmonë prishet sepse aty ndikon uji. Nëse, është fjala për rregullimin e parqeve në Komunën e Obiliqit, përfshihet tërë lokaliteti dhe në sistem nuk ka mundësi të ceket vendi, prandaj Obiliqi e përfshin tërë territorin e Obiliqit dmth jo vetëm qendrën, por edhe fshatrat. Rruga Palaj, është në projekt me Ministrinë e infrastrukturës dhe drunjët do të mbjellen në fazën vjeshtore. Në stafin e Kuvendit komunal janë 21 anëtarë, plus stafi. Nëse, dikush është i interesuar me hapë një radio lokale edhe ne jemi të gjendje me mbështetë aq sa na lejon ligji. Sa i përket informimit ne i publikojmë vendimet dhe dokumentet tjera, në faqen zyrtare dhe pse tash ka problem MAPL-ja, me faqen zyrtare ne s'jemi fajtor.

Enver Grajqevci – Sa i përket pyetjes së z.Aziz Bici, për projektin e urës dhe rrugës që lidhë Plemetin me Hamidinë, ura ka qenë projekt në disa faza, në disa vite, pothuajse që punimet janë përfunduar. Ndërsa, sa i përket rrugës Kryetari i Komunës me ministrin e Ministrisë së infrastrukturës ka nënshkruar një memorandum në fillim të vitit dhe ne i kemi udhëheqë këto procedura që na kanë takue si Drejtori dhe e kemi dërgue në Zyrën e Prokurimit për shpallje të tenderit për atë rrugë, por edhe më gjatë renovimi i rrugës Palaj-Lajthishtë e deri në Shipitullë, renovimi i asaj pjese. Kjo kontratë nëse, nuk është lidhë këtë javë, do të lidhet në javën tjetër dhe do të fillojnë punimet. Mirëpo, e keqja e saj është se punimet do të zgjatin 24 muaj dhe këtë vit janë të ndara 50,000 €, dhe të shohim se a do të ketë ndonjë lëvizje në buxhetin e nivelit qendror për me u plotësue më shumë me mjete. Këtu, do të përfshihet rruga Plemetin-Hamidi dhe prej Palajve, Lajthishtë deri në Shipitullë. Sa i përket çështjes së nënkalimeve në magjistralen nën 2, kjo është kompetencë e Ministrisë dhe në njërin nënkalim sa jemi në njohuri në

Millosevë, kanë probleme me disnivele e shkarkimit të ujërave nëntokësore. Sa i përket nënkalimeve tjera, është çështje e Ministrisë dhe ne kemi kontakte të shpeshta, kështu sivjet do të ndërmarrin hapa më konkret për funksionalizimin e atyre nënkalimeve. Sa i përket çështjes së ngritur nga z.Lulzim Sadiku, pse vetëm në Obiliq, është e vërtetë se disa emërtime kanë mbetë jo në formën e duhur të formulimit psh të Drejtoria e infrastrukturës, shkruan asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve në Obiliq. Unë jam përpjekë që ta ndryshojmë këtë emërtim sepse përveç asfaltimit e kemi edhe shtruarjen e rrugëve me kubëza, por nuk di pse s'ka ndodhë ky ndryshim. Lidhur me emërtimin e projekteve tjera, duhet me qenë më të gjeneralizueme psh rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në Komunën e Obiliqit. Kjo, është e njëjtë edhe me disa emërtime në disa vija tjera dhe nuk është punë që s'mund të bëhet, por është në kompetencë të Drejtorive tjera.

Arben Berisha – Sa i përket çështjes së drunjëve 70%, të z.Lulzim Sadiku, unë e kam thënë më heret dhe po e them prapë se kjo përqindje duhet të llogaritet mirë pastaj me u nxjerrë sepse nuk është ashtu. Ju e keni dhënë të saktë se afër 6,000 drunjë janë mbjellë prej vitit 2014 e deri tash, të dëmtuar deri në fund të vitit 2017, kanë qenë 1,170 dhe zëvendësimi i tyre ka ndodhë në vitin 2018. Përqindja e drunjëve të dëmtuar janë 19,5 % dhe kjo është e dhënë e saktë. Ju jeni anëtarë të Kuvendit dhe keni obligim, prandaj mos jepni përqindje se nuk qëndron ashtu në realitet. Sigurisht se do të duhej me qenë më shumë drunjë, por për realitetin që është mendoj se është shumë mirë.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, po ndjehem keq vetëm nëse formoni një Komision për rr.Palaj-Obiliq, drunjët e mbjellur janë mbi 90 %, të dëmtuar. Unë nuk akuzova pse, por thashë në këtë 30,000 €, kërkoj që ato të ndahen për mirëmbajtje, e jo për mbjellje sepse nëse ne mbjellim e nuk mund ti mirëmbajmë, atëherë rezultati është barazi me 0. Unë jam shumë bindës për shifrat që i kam thënë, jam shumë afër edhe pse nuk i kam numrue me numër, këtë mund ta vërtetoj një Komision nëse formohet përndryshe, jo që mund ta vërtetoj ish drejtori.

Arben Berisha – Ndoshta, anëtari i Kuvendit ka harrue se në vitin e kaluar i kemi zotue 80,000 €, për mirëmbajtje 2 vjeçare dhe me të dhëna të sakta i kemi 60,000 €, që ai e ka fitue tenderin për mirëmbajtje 2 vjeçare. Poashtu, nga të reshurat e shiut aty është e pamundur të punohet dhe kryesorja është kompania për mirëmbajtje, janë mbjelljet e drunjëve dhe natyrisht se ka vend për me qenë më mirë.

Aziz Bici – Nuk e kuptova përgjegjen për rrugën për Mirash, dhe nuk e di a e dhanë përgjegjen apo jo. Poashtu, për urën dhe rrugën nëpër Hamidi, mendoj se duhet me i dhënë prioritet të madh asaj pa dallim se donacion i kujt është ajo sepse është në pyetje lëvizja e shumë banorëve të fshatrave. Atë rrugë mundën me shfrytëzue edhe fshati Sibofc, derisa të përfundohet atje lartë mundet edhe Lajthishta, është shumë me prioritet.

Burim Gërguri – Sqaron se me rrugën për Mirash, Kryetari i Komunës është marrë me të qe 4 vite dhe z.Hysni Mjeku, ka bërë përpjekje meqenëse është zonë me interes nacional. Në këtë fazë është bukur vështirë për shkak të sigurisë dhe objekteve që janë aty. Sa i përket rrugës dhe urës që i lidhë, dua të them se ura ka qenë një ëndërr, por është bërë realitet, është në fazën përfundimtare, është në proces të tenderimit.

Enver Grajqevci – Me vetë faktin që thashë pritet të nënshkruhet kontrata në javën e ardhshme nëse, nuk është nënshkruar në këtë javë, çfarë fjale ka përveç se e kemi marrë me seriozitet dhe me prioritet ndërsa çështja e fondeve është çështje tjetër. Sa i përket rrugës Hamidi- Sibofc, nuk ka mund me hy në këtë pjesë, por do ta rregullojmë me fonde komunale në këtë vit. Në rast se nuk ka lëvizje buxhetore nga Ministria, ne do të arrijmë ta funksionalizojmë me shtresa të zhavorrit deri në vitin tjetër.

Burim Gërguri - Në finalizim të buxhetit duhet të përfshihet edhe pjesa e Ligjit për Obiliqin, me një kusht drejtoreshë që në planifikimin e buxhetit në shtator me u ulë si Komitet dhe si Kuvend komunal me i harmonizue propozimet dhe vërejtjet e dhëna, në mënyrë që Korniza, të jetë pak a shumë me buxhetin.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota "Për" 6 vota "Abstenim" dhe 2 anëtarë nuk morën pjesë në votim morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet (KAB) Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021.

Pika e pestë e rendit të ditës –

Burim Gërguri – Ju njoftoj me një projekt madhor parkun e qytetit dhe Drejtoria për infrastrukturë është duke udhëheqë me procedurat e Prokurimit dhe tenderimit. Tani do të prezentohet para juve, bashkë me stafin teknik se si do të duket sheshi i madh i qytetit.

Kaltrina Spahiu – Prezenton përmes sllajdeve detyrat projektuese që është dashur ti përmbahet operatori ekonomik për hartimin e projekt idesë për sheshin e qytetit. Në këtë rast përfshihen objektivat si dhe planet e Rregulloret, q ë është dashur ti përmbahen.

Fatos Kurshumlja – Që të 2 projektet ishin të mira, por tash nuk e di se cili do të përzgjedhet. Te lapidari i dëshmorëve, nuk e di a është paraparaë të shenohen emrat e të gjithë dëshmorëve të Komunës së Obiliqit, apo vetëm ata që kanë ndërrue jetë në Obiliq. Pasi që po bëhet ky projekt madhor a keni mendue diçka edhe për stacionin e policisë sepse mendoj se stacioni duhet të zhvendoset nga aty dhe ajo hapësirë le të mbetet park i qytetit. Projekti i dytë nëse, është taman park, mendoj se rruga njëkahëshe duhet të mbyllet dhe të kthehet andej nga kisha prapa banesave të Hades dhe të delë te rrethi kryesor i qytetit.

Kaltrina Spahiu – Përgjegjet se te propozimi i parë pjesa e lapidarit ka të inkorporuar 14 shtylla në lartësi deri në 4 metra dhe i ka të gdhendur emrat e dëshmorëve. Kjo është vetëm një koncept, ide, ndërsa për detale të hollësishme merremi me projektin kryesor. Vërejtja juaj do të merret parasysh në të ardhmen kur të hartohen edhe kërkesat për projektin kryesor. E njejtja përgjegje vlen edhe për propozimin e dytë. Sa i përket hapësirës së stacionit policor, në kërkesë nuk ka ndonjë ide se çka me ndërmarre.

Osman Kabashi – Sqaron se pjesa e stacionit policor në këtë fazë nuk është e paraparaë me u zhvendosë, por në të ardhmen ka mundësi. Ne do të shkojmë në sistemin si Komuna e Prishtinës, që ka realizuar njëherë sheshin “Ibrahim Rugova” pastaj ka vazhdue edhe me sheshet tjera.

Enver Grajqevci – Ju informoj se projekti do të jetë në faza 36 muaj dhe në këtë vit janë të ndara 300,000 €, si dhe parashihet zhvendosja e disa objekteve, që edhe ato kanë kosto. Sa i përket çështjes së ngritur nga z.Fatos, është mendue oborri para stacionit policor dhe rruga e stacionit policor të hapet mbi qendrën e regjistrimit civil. Ndërsa, sa i përket asaj që rruga me u blloku e tëra, aty ka pronar privat, ka zhvillime dhe Komuna nuk duhet me bllokue, por me bë zgjidhje sepse një pjesë e tyre nuk kanë qasje nga prapa. Prandaj, ka qenë kërkesë nga organet komunale me lënë një rrugicë njëkahëshe.

Fatmir Bektashi – Meqë, drejtori i infrastrukturës e përmendi shpronësimin e bizneseve, pyes se për banorët në objektin e vjetër a keni bërë ndonjë plan se ku do ti zhvendosni dhe si do ti caktoni çmimet e m² për ato shtëpi sepse janë disa familje që jetojnë në atë objekt, te lapidari.

Enver Grajqevci – Përgjegjet se forma shpronësim ose kompenzim është formë që duhet të mendoj komplet stafi i Komunës. Ne i kemi disa hapësira në pjesë të ndryshme dhe ka mundësi edhe të ndërrimit.

Armend Rushiti – Mendoj se janë projekte të mira, por kisha me veçue projektin e dytë dhe kam një pyetje te projekti i dytë se nuk e di a pati diçka aty për këndin e lojërave për fëmijë.

Kaltrina Spahiu – Përgjegjet se për kënd të lojërave operatori në propozimin e dytë nuk ka planifikue diçka konkrete, përveç këndit rekreativo-sportiv, por ka mundësi të ndryshimeve deri në 10 %, e kjo nënkupton edhe këndin e lojërave për fëmijë.

Shaip Paloja – Mendoj se debatet publike për këtë shesh nuk janë mbajtë ashtu qysh është dashur të mbahen. Te projekti i dytë mendoj se afër sheshit nuk duhet të ketë rrugë, por duhet të gjendet rrugë alternative sepse edhe shesh, edhe shetitore, edhe kohëpaskohe vetura, atëherë nuk e ka kuptimin e sheshit. Këtu, do të dëmtohen shumë bizneset, që nuk e di a është verifikue se sa do të kushtoj dhe do të bëhet zhvendosja e disa ndërtesave, që u përmendë këtu rrënimi i ish Shtëpisë së kulturës, dhe aty është një pjesë e njerëzve që duhet me u vendosë. Poashtu, objekti te stacioni policor do ta ketë një kosto. Mendoj se sheshi do të ketë një përmbyllje komplet se sa do të kushtoj me zhvendosje dhe me dislokim të njerëzve. Aty, duhet të ketë edhe shpronësime të shumta duke marrë parasysh se e kemi shkollën

“Ibrahim Rugova” që aty duhet patjetër të zgjerohen ato rrugë sepse do të ketë shumë qarkullim. Këtu, nuk po e shohë si alternativë apo këto nuk janë dhënë në projekt. Këtu, u tha se sheshi do të përfundoj brenda 2 viteve, por qysh e pashë unë as brenda 4 viteve dhe sheshi nuk e ka kuptimin me u ndërtue me faza, por duhet të ketë një datë të caktuar se kur do të përfundoj.

Enver Grajqevci – 36 muaj ka kohë për ndërtim të sheshit, e jo 24 muaj sepse sheshet dojnë zhvillime pak më të gjëra dhe zgjasin projektet. Ju e përmendët shkollën “Ibrahim Rugova” por cila shkollë ndoshta, shkolla e mesme dhe unë nuk di se çka ndërlidhet me këtë pjesë.

Nazmi Gashi –

Hysni Mjeku - unë jam për me ndërpre komunikacionin që nga rruga që shkon për Palaj, në mënyrë që ta kemi një shesh ashtu qysh e meriton Obiliqi. Këtu, u potencua që stacioni policor të rrenohet dhe unë propozoj që edhe posta ta ketë të njejtin fat sepse është shumë afër Shtëpisë së kulturës, që edhe ashtu e ka një pamje jashtëzakonisht të shëmtuar, që nuk meriton të jetë aty. Është paraparë të jetë edhe një statujë e “Nënës Terezë” që këtu fare nuk u potencu dhe pyes pse nuk u potencu sepse statuja e Nënës Terezë duhet ta ketë vendin e merituar aty ku është paraparë. Këtu, u folë edhe për dëmtimin e bizneseve, por ne nuk guxojmë të jemi viktimë e 100 bizneseve, ta zëmë me 30,000 banorë. Ju lutem ne po bëjmë projekt për 30,000 banorë, e jo për 100 banorë që aty e zhvillojnë biznesin. Mendoj se Shtëpisë së kulturës duhet ti jepet një hapësirë më e madhe sepse shumica e aktiviteteve kulturore bëhen rreth saj. Sa i përket ndriçimit, unë nga aspekti teknik nuk e di se cilat standarde janë, por kishte me qenë mirë të bëhet si Peja që e ka zbatue një ndriçim të kapshëm për sy, e jo këto shtylla të cilat janë demode nga koha e sistemit të kaluar. Mendoj se debati duhet të vazhdohet me qytetarë dhe të jepen propozimet.

Burim Gërguri - unë i gëzohem faktit që po bëhet një shesh i mirë për Obiliqin dhe kërkesat janë të mëdha, por ne mund të veprojmë në kuadër të mundësive tona. DPUKP dhe DMM-ja, po mundohen me gjetë zgjidhjen lidhur me objektet e vjetra, por së pari duhet të zgjidhet problemi i pronësisë.

Armend Rushiti – Pyet se a mund të shtypet ky material për neve.

Kaltrina Spahiu - Përgjegjet se për me shtyp materialin, ne duhet të konsultohemi me Zyren e Prokurimit sepse ende nuk është bërë testimi definitiv i projektit të BE-së.

Burim Gërguri – Ju njoftoj me Planin e punës të Komitetit për komunitete, për vitin 2018 dhe ne vetëm i urojmë sukses në realizimin e këtij plani.

Arben Berisha – Lexon kërkesat e KEDS-it, për ndarjen e parcelave për vendosjen e trafostacionit shtyllë dhe stabilimentit shpërndarës për furnizim me energji elektrike më kualitative për banorët e fshatrave.

Shaip Paloja – Kur e kemi parasysh se kompania e KEDS-it, është private mendoj se ai duhet të paguaj tokën e Komunës, për vendosjen e trafos sepse toka ku vendoset trafoja nuk është pronë e KEK-ut. Unë e di se është interes i qytetarëve në përgjithësi, por po çuditëm pse me ju dhënë tokë.

Arben Berisha – Edhe unë e kam pasë këtë dyshim si ti, por ligji e thotë dhënja e pronës së paluejtshme të Komunës në shfrytëzim me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë dhe për këtë ju lus të votoni.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Aprovohen kërkesat e DPUKP me nr.V-561, të dt.12.06.2018, për ndarjen e parcelave sipas kërkesave të KEDS-it, 4675, të dt.01.03.2018, dhe kërkesa me nr.11923, të dt.17.05.2018, të cilat kanë të bëjnë me dhënjen në shfrytëzim për parcelat me nr.00866-0, ZK Obiliq, Plemetin në hapësirë prej 20 m² dhe nr.00654-0, ZK Leshkoshiq P.SH. Rrugë pronë shoqërore në hapësirë prej 9 m².

Arbnore Nasufi – E kam një kërkesë nga qytetarët e Obiliqit, konkretisht të prindërve fëmijët e të cilëve vijnë mësimin në SHF “Pandeli Sotiri” lagjja e Hashanëve. Unë dua të informohem nga ju se cila është arsyeja që kjo shkollë që nga hapja e saj e deri më sot nuk ka një pllakë me mbishkrim ku shihet emri i saj. Poashtu, e kam një kërkesë që të rregullohet oborri i kësaj shkolle sepse i ka humbë imazhi i shkollës

me një oborr të tillë. Gjithashtu, edhe paralelja e ndarë në Plemetin, oborri i shkollës është pothuajse në gjendje të mjerueshme. Këtë kërkesë ia adresoj DKA-së dhe shpresoj të gjejë përkrahje nga kjo Drejtori.

Fatos Kurshumlja – E pata një kërkesë për drejtorin e infrastrukturës dhe më heret biseduam me drejtorin për rrugën që lidhë fshatin Lajthishtë dhe Grabofc, e Sibofc andej dhe shpresoj të niset ajo rrugë sa më shpejt. Mirëpo, kam edhe një kërkesë për 2 rrugë: "Shtabi i UÇK" që lidhet me rr."Marigona" është e vetmja rrugë në fshat që nuk ka kanalizim ose ujërat e zeza kyqen në rrugën kryesore. E kam edhe një kërkesë të lagjes së Trebunjëve, për asfaltim 300 metra që është mjaft e nevojshme sepse gjatë dimrit është e pakalueshme.

Enver Grajqevci – Sqaron se janë në planifikim që të shtrohen edhe ato rrugë, por është çështje e buxhetit dhe të shohim se çka mund të kryejmë sivjet, ndërsa për kanalizim ata e kanë një pjesë të kanalizimit aty, por jo të duhur, kështu që brenda vitit do ta rregullojmë.

Fatmir Bektoshi – E kam një pyetje për drejtorin e infrastrukturës, javën e kaluar kemi pasë takim me disa qytetarë dhe problemi është se janë duke e sistemuar kabllovikun dhe punëkryesi e ka dëmtuar rrugën pothuajse 90 %. DSHPE-ja, ka dalë në vendin e ngjarjes, por duhet me dalë më shpesh dhe me pa gjendjen. Çështja për drejtorin e infrastrukturës është se kanali është mbyllë dhe ujërat e zeza dalin mbi asfalt. Ju lus të dilni më shpesh në lagjen "Imeraj".

Shaip Paloja – E kam një kërkesë prej qytetarëve, te tabelat e emërtimeve të rrugëve ka disa vende që janë të dëmtuara, konkretisht kam marrë një kërkesë prej lagjes "Aliu" aty paska ndodhë një aksident më heret dhe tabela "Martirët Aliu" kanë kërkuar me vendosë prapë dmth me kthye.

Burim Gërguri – DSHPE-ja, dhe Drejtoria për infrastrukturë janë duke u marrë me këtë çështje sepse ka pasë edhe gabime teknike.

Mbledhja përfundoi në ora 12:40'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri

